

**26 QERSHORI
DITA NDËRKOMBËTARE
E KOMBEVE TË BASHKUARA
NË MBËSHTETJE TË VIKTIMAVE
TË TORTURËS**

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në mënyrë zyrtare ka shpallur 26 Qershorin si Ditë Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të Viktimave të Torturës me 12 Dhjetor 1997. Është zgjedhur kjo datë pasi që pikërisht me 26 Qershor 1987 ka hyrë në fuqi Konventa e KB kundër Torturës dhe Veprimeve tjera Çnjerëzore e Degraduese.

Çdo vit, me 26 Qershor,
mijëra njerëz në regjione të ndryshme të botës
i bashkohen zërit kundër torturës.

Në vitin 2004, tortura ende mbetet një problem serioz,
dhe si i tillë kërkon vëmendje të plotë të qeverive
dhe organizatave joqeveritare në çrrënjosjen e saj.

*Neni 14 i Konventës së KB kundër Torturës
përcakton detyrimet e shteteve anëtare të K.B.
të cilat janë pjesëmarrëse në Konventë për të siguruar
Reparacionin për viktimat e torturës.*

REPARACIONI

Është një parakusht themelor
për rehabilitimin e viktimave të torturës,
promovimin e paqes, pajtimin dhe stabilitetin
në shoqëritë e përçara.

• Rehabilitim

Ashtu siç zhdukja e torturës
është një parakusht për demokracinë
dhe të drejtat e njeriut,
ashtu është edhe trajtimi i specializuar
rehabilitues për viktimën e torturës.
Viktima e torturës duhet të ketë qasje
në trajtimin dhe shërbimet fizike e psikologjike,
këshillime sociale, fizioterapi, terapi okupuese,
trajtim dental dhe mbështetje tjera, sipas nevojës.

Qeveritë kanë detyrime të sigurojnë
që një ekspertizë të tillë të vihet në dispozicion
të viktimave të torturës
dhe familjeve të tyre pa kompensim.

• Rimbursim

Rimbursimi synon të rimëkëmbë jetën
e viktimës së torturës siç ishte para se personi
t'i nënshtrohej torturës.
Kjo mund të përfshijë rimëkëmbjen e lirisë,
jetës familjare dhe lirie të tjera,
pronës, kapitalit të vjedhur,
statusit të qytetarit dhe pjesëmarrjes në jetën civile.

• Kompensim

Kompensimi përfshinë kompensimin
financiar për të gjitha dëmet e shkaktuara
në periudhën e konflikteve - luftërave,
dëmet monetare-materiale dhe jo monetare
(fizike , morale dhe shpirtërore).

**TË DREJTËN PËR SATISFAKSION
DHE GARANCION PËR MOSPËRSËRITJE**

Satisfakcioni synon që viktima e torturës
të dëmshpërblehet për të këqijat që i janë bërë
dhe të rimëkëmbet dinjiteti i saj.

Kjo përfshinë një pagesë nga shteti
për njohjen e atij akti të kryer të Torturës.
Satisfakcioni mund të jetë simbolik,
si pjesëmarrja në përkujtimore,
publikimi i së vërtetës, përmes forumeve,
komisioneve, gjyqeve etj.

Marrja e masave për garancion
për mos përsëritje nga shteti mund të bëhet
përmes dokumentimit të praktikave
të torturës, ose bërjes së ndryshimeve
legjislative dhe administrative në përputhje me
detyrimet ligjore ndërkombëtare,
si edhe duke mos lejuar ushtrimin e torturës.

Është viti i dymbëdhjetë që
„Q K R M T”

shënon Ditën Ndërkombëtare të KB
në Mbështetje të Viktimave të Torturës
me aktivitete dhe mesazhe të ndryshme
duke avokuar dhe ndërgjegjësuar institucionet
vendimmarrëses për përmirësimin e situatës
se viktimave të torturës si dhe parandalimin saj.
Është kjo ditë ku në mbarë botën apelohej për
parandalimin e torturës si dhe ngritët zëri
për nevojën e domosdoshme për rehabilitim
dhe reintegrimin të viktimave të torturës,
duke mos e përjashtuar as vendin tonë.

Këtë vit QKRMT është më e përkushtuar
në avokimin e të drejtave të viktimave
të torturës për reparacion e ne veçanti

**TORURA
ËSHTË SHKAK DHE PASOJË E VARFËRISË
PRA LE TA KËPUSIM ZINGJIRIN !**



**QKRMT
KRCT**

QENDRA KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E TË MBIJETUARVE TË TORTURËS
KOSOVA REHABILITATION CENTRE FOR TORTURE VICTIMS



MISIONI

(QKRMT)

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës ka për mision të përmirësoj mirëqenien e viktimave të torturës dhe të përmirësoj gjendjen e tyre përmes rehabilitimit, riintegritimit dhe risocializimit.

Roli kyç i QKRMT-së është të ofroj shërbime më të mirat të mundshme dhe përpjekjet tona janë të drejtuara për të siguruar trajtim profesional, cilësor dhe të vazhdueshëm.

QKRMT punon me mjekë, psikologë, psikiatër, punëtor social dhe këshilltarë ligjorë me qëllim që të siguroj klientëve tanë trajtim disiplinor dhe efektiv. QKRMT ka filluar me shërbime e saja që nga fundi i luftës. QKRMT ka marr udhëheqjen në ofrimin e trajtimeve profesionale dhe atyre individuale të përshtatura nevojave të grupit tone targetues Në Kosovë, QKRMT është anëtare aktive e shoqërisë civile dhe merr pjesë në të gjithat ngjarjet e rëndësishme. Po ashtu, jemi të përfshirë në rrjete ndërkombëtare dhe jemi pjesë e Këshillit të nga Qendrës Ndërkombëtare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (IRCT) dhe anëtarë të rrjeteve tjera regionale.

Adresa :Hamëz Jashari, No 16/b2
Lagja Dodona, Prishtina,
Prishtina, 10 000Kosova
Tel/Fax: +381 38 243 707
Email:feride.rushiti@krct.org
website: www.krct.org



**QKRMT
KRCT**

QENDRA KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E TË MBIJETUARVE TË TORTURËS
KOSOVA REHABILITATION CENTRE FOR TORTURE VICTIMS

DIJA NDËRKOMBËTARE NË MBROHTJE TË VIKTIMAVE TË TORTURËS

26
QERSHORI

Tortura është shkak dhe pasojë e varfërisë
Le ta këpusim zinxhirin

26. Qershor - Dita Ndërkombëtare e Përkrahje të Viktimave të Torturës
International Rehabilitation
Day for Torture Victims

WIT.DIGI.NAINE